

VENDIM
Nr. 136, datë 6.3.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 414, DATË 27.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE TË NGURTA TË RAJONIT TË VLORËS’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 414, datë 27.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës’”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, vlera “... prej 29 442 300 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e dyzet e dy mijë e treqind) lekësh.” zëvendësohet me “... prej 32 768 112 (tridhjetë e dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë e mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh.”;

b) Pika 4 riformulohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 32 768 112 (tridhjetë e dy milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) Vlera prej 29 442 300 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e dyzet e dy mijë e treqind) lekësh mbulohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2020;

b) Vlera prej 3 325 812 (tre milionë e treqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekësh përballohet nga Bashkia Vlorë.”;

c) Tabelës, bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Vlorë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “MENAXHIMI I INTEGRUAR I MBETJEVE TË NGURTA TË RAJONIT TË VLORËS”

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr./pasurisë	Lloji i objektit	Sipërfaqe shpronësimi m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale/lekë
59	NOVRUZ SHABAN ISUFAJ	2074	645/10	Arë	862.0	204	175,848
60	AVERON REJT ZYBERAJ	2074	645/60	Arë	3400.0	204	693,600
61	KIMET BATJAR HOXHAI	2074	645/67	Arë	1600.0	204	326,400
62	VALBONA ELHAM TORO DEFRIM ELHAM TORO DELI ELHAM TORO FATOS ELHAM TORO BLEDAR ELHAM TORO NEXHP ELHAM TORO VIKTORI ELHAM TORO GERANTINE BEKTASH TORO	2074	645/94	Arë	6400.0	204	1,305,600
63	AGIM MUHAMET VELAJ	2074	645/71	Arë	3870	204	789,480
64	AGIM MUHAMET VELAJ	2074	645/72	Arë	171.0	204	34,884

VLERA TOTALE	3,325,812
--------------	-----------